



Nr. 831/4 Prot

Durrës, më: 03.04.2026

V E N D I M

Nr. 28, datë 03.04.2026
PËR

"MBYLLJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, BACHELOR NË "INFORMATIKË-ANGLISHT" PRANË FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; bazuar në Kreun IV/C "Procedurat për mbylljen e programeve të studimit" të Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Statutin e UAMD; në Rregulloren e UAMD-së; referuar shkresës nr. 2316/2 prot., datë 04.11.2025 të Njesisë Kryesore të FTI-së, si dhe referuar relacionit Nr. 743 prot., datë 24.03.2026 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, vendimit të Senatit Akademik nr. 53, datë 30.03.2026, Bordi i Administrimit

V E N D O S I:

1. Miratimin e mbylljes së programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Informatikë-Anglisht" pranë Departamentit të Shkencave Kompjuterike në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2026-2027.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore FTI

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALLAJ

